

TREGIMI I PEJGAMBERIT

# DAVUD



Özkan Öze  
Ilustroi: Sevgi İçigen

TREGIMI I PEJGAMBERIT

# DAVUD



Në pamjet që ilustrojnë libërthata e kësaj serie botimesh për fëmijë nuk do të shihni asnjë nga fytyrat e pejgamberëve. Kjo sepse muslimanët nuk bëjnë portrete të pejgamberëve, për shkak të respektit që ndiejnë ndaj tyre.



**BOTIMET E KRYESISË SË ÇËSHJTJEVE FETARE TË TURQISË: 1706/7**  
**Libra për fëmijë: 349/7**

**Drejtuesi i botimeve:**

Dr. Fatih Kurt

**Koordinatori i botimeve:**

Lokman Arslan

**Analizimi i veprës:**

Hale Şahin

Elif Erdem

**Editor**

Zeynep Ulviye Özkan

**Përktheu**

Florida Kulla

**Redaktor gjuhësor**

Fatjon Cuka

**Ndjekja e botimit**

Uğur Altuntop

**Botimi**

Bapak Mat. Tanı. Hiz. İth. İhr. Tic. Ltd. Şti.

Tel.: +90 312 397 16 17

Botimi i tretë, Ankara 2019

2019-06-Y-0003-1706

ISBN 978-605-7730-91-6

Numri i certifikatës: 12930

Vendimi i komisionit të hetimit të veprave : 12.11.2019/111

© Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë

**Kontakt**

Dini Yayınlar Genel Müdürlüğü

Yabancı Dil ve Lehçelerde Yayınlar Daire Başkanlığı

Üniversiteler Mah. Dumlupınar Bulvarı No: 147/A

06800 Çankaya - ANKARA / TÜRKİYE

Tel.: +90 312 295 72 81 • Fax: +90 312 284 72 88

E-posta: yabancidiller@diyanet.gov.tr





Një herë e një kohë... Në një periudhë shumë të hershme...

Në Palestinë jetonte një burrë me emrin Isha.

Ishai kishte dymbëdhjetë djem dhe çdonjëri prej tyre ishte më i fuqishëm e më shtatlartë se tjetri.

Ishai kishte edhe Davudin!

Davudi ishte një fëmijë i dobët dhe i pafuqishëm.


Kur dikush e shihte atë ndërmjet vëllezërve të tjerë, mendonte:

“Me sa duket ky fëmijë është i sëmurë.”

I ati, Isha, mërzitej shumë me gjendjen e Davudit,  
madje edhe turpërohej disi.

Nuk dëshironte që Davudi të binte në sy të të  
tjerëve.

E dërgonte atë larg njerëzve, nëpër male, që të  
kulloste delet






Davudi ishte i pafuqishëm, i dobët, i hollë dhe i brishtë, por kishte disa veçori që nuk gjendeshin te vëllezërit e tjerë.

Allahu i kishte dhënë Davudit një zë shumë të bukur.  
Nëpër male, shpate me lule, në luginat e gjelbra  
këndonte këngë dhe ilahi falënderimi për Allahun që  
kishte krijuar të gjitha këto bukuri.







Edhe zogjtë heshtnin e dëgjonin Davudin.  
Era u bënte shoqëri këngëve të Davudit  
dhe zërin që bënte jehonë nëpër male e dërgonte  
deri te melekët  
Një veçori tjetër e Davudit ishte se përdorte shumë  
mirë llastikun, nëpërmjet të cilit gjuante me gurë.  
Kudo që të hidhte gur qëllonte mu në shenjë!  
Nuk kish ndodhur asnjëherë që të mos qëllonte në  
shenjë.

Një ditë prej ditësh, në vendin e Davudit nisi lufta.  
Një komandant i pamëshirshëm me emrin Xhalut  
ishte nisur drejt vendit të Davudit bashkë me  
ushtarët e tij.

Nga shtati Xhaluti ishte thuajse një  
gjigand.

Ai ishte edhe shumë i fuqishëm  
dhe tejet mizor.





Populli i Davudit kishte një mbret me emrin Talut  
Taluti i ftoi të gjithë që të luftonin me Xhalutin.  
Edhe vëllezërit shtatlartë të Davudit ishin bashkuar  
me ushtrinë.

Taluti dhe ushtria e tij u nisën për rrugë që të  
luftonin me Xhalutin.

Rruga i çoi buzë një lumi.

Të gjithë ata që ecnin prej ditësh i kishte zënë etja,  
por një etje e pazakontë.





Taluti u tha: "Urdhëroni, pini, por jo më shumë se një gllënjë. Po pitë më shumë nuk jeni ushtarët e mi!"

Këtij urdhri iu bind vetëm një pjesë e vogël e  
ushtarëve.

Pjesa më e madhe pinë sa u ngopën.






Ata që pinë shumë ujë hoqën dorë nga lufta me Xhalutin.

Ushtria e Talutit mbeti krejt e vogël.


Si do ta mposhtte ushtrinë e Xhalutit tani kjo ushtri kaq e vogël?

Davudi, i cili në atë kohë po kullostte delet, dëgjoi një zë nga qielli.

“O Davud! Xhalutin do ta mposhtësh ti.  
Lërja amanet Allahut delet dhe bashkohu me vëllezërit e tu!”







Davudi vrapoi e vrapoi...  
dhe e arriti ushtrinë.  
Por ushtria ishte shumë  
e paktë dhe Davudi ishte  
shumë i pafuqishëm...

Allahu im! Sa i frikshëm dukej Xhaluti.  
Kishte një përmendore të stërmadhe në kokë.  
Ishte mbi një kalë shumë të madh.  
Ai ishte një gjigand që s'ish mposhtur kurrë gjer atë  
ditë.  
Xhaluti kaloi para dhe kërkoi nga Taluti që të  
dërgonte dikë për dyluftim.  
Taluti tha: "Kush do të luftojë me këtë?"  
Askush nuk nxori zë!





Vetëm Davudi doli para  
dhe tha: "Do të luftoj unë!"

Davudi nuk kishte as mburojë e as  
shpatë.

Në dorë kishte vetëm llastikun  
dhe gurët që pati mbledhur gjatë  
rrugës kur po vinte.

Xhaluti qeshi kur e pa.

Tha: "Me gur do të më mposhtësh mua?"

Davudi i hodhi një gur Xhalutit

Guri fluturoi e fluturoi dhe u ngjit në mes të dy  
vetullave të gjigandit, bam!


Xhaluti ra nga kali dhe u rrëzua përtokë.

Luftën e fitoi ushtria e paktë e Talutit





Pas luftës Taluti e martoi Davudin me bijën e tij.  
Kur Taluti vdiq, Davudi u bë mbret  
Ai ishte një njeri shumë i mëshirshëm dhe i mençur.  
Allahu e zgjodhi atë si peygamber  
dhe i dërgoi një libër me titullin *Zebur*.  
Peygamberi Davud adhuronte shumë.  
Këndonte *Zeburin* deri në mëngjes.  
Toka dhe qiejt dëgjonin zërin e tij të bukur.





Ai ishte mbret,  
por punonte si farkëtar dhe e siguronte  
jetesën me duart e veta.  
Ja, pra, këto që rrëfyem më sipër janë historia  
e Pejgamberit Davud...  
Dhe është një shembull i bukur që tregon se si  
të pakëtit mposhtin të shumtit dhe të dobëtit  
të fuqishmit  
Të gjitha këto me ndihmën e Allahut..

